

Të parandalohen kafshimet e bishtit te gicat që janë në gji dhe në rast nevoje dhe të pengohen

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka



Çfarë është tërheqëse te kafshët dhe çfarë duhet patur në përdorim? Për këtë çështje janë përdorur pajsisje dhe mjete të ndryshme në kuadër të eksperimenteve për temën kafshimet në bisht. Këto janë vlerat e para të përvojës për përdorimin e pajisjeve dhe të masave me anë të të cilave mund të pengohet një kafshim akut.

Pajsisjet duhet të jenë përherë tërheqëse

Te pajisjet që përdorim duhet të kemi parasysh që të jenë përherë tërheqëse. Të pafavorshme në këtë drejtim janë pajisjet që varen veç e veç në murin ndarës të bokseve dhe mund të "përpunohet" vetëm nga një gic.

Në përgjithësi vlen: Numri i pajisjeve të përdorshme duhet të shtohet me rritjen e numrit të kafshëve. Për gjashtë deri në dymbëdhjetë derra duhet të jetë e disponueshme minimalisht një lodër. Eksperimentet tregojnë, që gica të veçantë kanë "preferenca " të veçanta. Shpesh të njëjtët

gica qëndronin në lodrën *Bite-Rite*, të tjerë pëlqenin më mirë të shtrëngojnë litarin, të tjerët preferonin copën e drurit në dysHEME, të cilën e shtynin me hundë dhe mund ta ngrinin lartë. Prandaj është e rëndësishme të ofrohen sende të ndryshme, në mënyrë të tillë që të përmbushet deri diku çdo preferencë.

Burimet materiale - të kushtueshme, por të pëlqyera

Si burime materialesh janë marrë materialet organike jo të dëmshme, të cilat kafshët mund t'i ndryshojnë ose mund t'i hanë. Kombinimi i objekteve me ushqimin i bën ata më tërheqës. Në direktivën austriake të 2004 për mbajtjen e kafshëve quhen: kashtë, sanë, dru, tallash, përzierje kërpudhash ose torfe. Sigurimi i materialeve përbën gjithmonë disa shpenzime, si gjetja e enëve të përshtatshme, të mbushet dhe nëse është e nevojshme dhe të ndërrohet në rast papastërtie.

Dhënia e celulozës dhe e ushqimit të strukturuar apo materiali i përdorshëm në eksperimentet tona rezultoi efektiv kundër kafshimit të bishtit. Interesant ishte fakti, që dhënia dy herë në ditë në sasi të vogla e kashtës dhe e jonxhës reduktonte dukshëm kafshimin dhe madje e ndalonte atë. Edhe pse përdorimi i pajisjeve zgjati pak, kafshimi i bishtit u reduktua brenda një dite nga 50 deri 90 përqind. Mesa duket se kanë ndikuar dhe cilësi të tjera të ushqimit të strukturuar në qetsimin e kafshëve. Pikërisht në këtë pikë duhet të bëhen kërkime të tjera.

Të krijojmë zbavitje dhe të gjejmë kafshuesin.

Parimisht këshillohet, që në rast të kafshimeve të bishtit, të tentohet si fillim të krijohet zbavitje. Në këtë pikë fantazisë nuk i vendosen limite-nëse përdoret bar apo kashtë, degë të pemëve frutore apo pemë halore, bimë misri, qese letre ose litar- gjithçka, që nuk dëmton kafshën, është përpjekje e vleshme dhe për gicat është diçka e këndshme.

Nëse kafshimi i bishtit nuk është shmangur ende përmes kësaj përpjekje, atëherë hasen plagë të freskëta, kështu që të paktën është arritur, që kafshët që ndukin, të merren tashmë me këto materiale. Kafshët ndukëse janë ato kafshë të cilat ndukin në bishtat e gjakosur, pa shkaktuar vet dëmtime të këqija në to. Vetëm kështu kemi mundësinë për të gjetur "keqbërësin" e vërtetë, i cili nuk tërhiqet nga kjo zbavitje. Në eksperimentet tona duhet të merret në dy nga tetë bokset ku rrijnë derrat e kafshuar dhe një derr i kafshuar nga boksi.

Për të gjetur kafshuesin, duhet të gjejmë një moment, kur të gjithë derrat në boks janë aktiv. Zakonisht kjo ndodh në orët e mbasdites. Normalisht mjafton të qëndrosh 10 minuta në anë të boksit, për të përcaktuar një apo dy derra të dyshuar si kafshues. Këtyre u bëjmë si fillim një shenjë me një stilolops që përdoret për të shënjuar bagëti. Ditën tjetër përsërisim të njëjtën gjë dhe nëse një nga dy derrat e shënuar kafshon, atëherë jemi relativisht të sigurtë se kemi gjetur derrin e duhur. Është e qartë sidomos, nëse kafsha e vëzhguar kafshon fortë. Me kafshim të fortë kuptojmë, nëse derri i kafshuar bërtet dhe tenton të largohet. Zakonisht kafshuesi nuk e lëshon bishtin e derrat të rënë pre, çka çon në dëmtime të mëdha dhe shkakton dhimbje. Një derr i tillë duhet të largohet nga boksi. Kashta në koritat e kashtës me pjesë mbajtëse në fund dhe me rogoz shtesë dhe ushqimi me jonxhë në një koritë nuk shkaktojnë te derrat e eksperimentuar asnjë problem me sistemin e plehut organik, edhe pse ajo ishte në dispozicion gjatë gjithë periudhës së rritjes së gicave. Veçanërisht jonxha u konsumua totalisht nga derrat. Maksimalisht bien vetëm disa gram në ditë nga rrjeta e koritës.

Nga rrjetat plastike me sipërfaqe të mbyllura mund të hidhet kashtë dhe direkt në boks si një masë akute për bokset e prekuar. Vrimat e mbajtëses plastike janë të ngushta dhe të shkurtra njëkohësisht në mënyrë të tillë që kafshata vendoset në mënyrë tërthore në të dhe zor se bie prej saj.

Kujdes duhet të tregohet te kolonat prej betoni. Këtu kashta mund të bjerë shpejtë, çka shkakton probleme pasi bie një sasi e caktuar. Në këtë rast kafshët nuk kanë faj. Duhet të gjenden alternativa, si korita me pjesë mbajtëse në fund ose korita me një pjesë mbajtëse të fiksuar në fund.